

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-  
Ministry of Culture, Youth &Sports*

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge  
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage  
Prizren**


DATE/A:	26.04.2017
REFERENC-Ë:	131/3
PËR/ZA/TO:	HIM-group Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
GA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.36 të dt.24.05.2017 për kërkësën e HIM-group nga Prizreni.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.

197

28. 04. 2017



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministry of Culture, Youth & Sports

131/2

27. 04. 2017


**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / MInistry of Culture, Youth & Sports**

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge  
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**

F. 27.04.2017.

DATË/A:	27.04.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 131/2
PËR/ZA/TO:	Komisioneri për Vlerësimin e Projekteve Restauruese Konservuese, HUMMI Prishtine
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samiq Jashari - Dëngjeli i QRTK-së Prizreni
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kurdi, bishku



Po Ju dërgojmë kundërshtimin e HUMM-ës përfyshim e refuzimin e kërkesës për dhënien e pëfqimit  
për ndërtimin e një pjese të kompleksit përbanor, në ngastrën kadastrale 1142-1 dhe 1142-2.

## MINISTRIA E KULTURES, RINISE DHE SPORTIT

### INSTITUTIT TË KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MONUMENTEVE

Kundër vendimit tuaj rreth 08/2017, takimi i tetë i datës 19.04.2017, edhe pse pa udhëzim juridik e i pakënaqur me këtë vendim parashtroj këtë:

#### KUNDËRSHTIM

Me të cilin e kundërshtoj vendimin e më lart shënuar si jo të drejtë, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit 02/L-88 për trashëgiminë kulturore
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike
- Aplikimit të gabuar të ligjit material

Me vendimin referencë 08/2017 të datës 19.04.2017, takimi i tetë, në mënyrë arbitrale është refuzuar kërkesa e subjektit HIM – grup nga Prizreni për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e një pjese të kompleksit për banim, në ngastrën kadastrale 1142-2, 1142-1, zona kadastrale Prizren, siç keni potencuar i cili tejkalon kriteret për ndërtim në zonat mbrojtëse të monumenteve të përcaktuara me ligjin nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore sipas nenit 2.21 dhe 6.4.

Shkeljet esenciale të dispozitave të ligjit 02/L-88 për trashëgiminë kulturore janë bërë pasiqë subjektit HIM – group nuk i është dhënë pëlqimi për ndërtimin e aneks kompleksit të kompleksit banesor me lokale afariste nën ngastrën kadastrale 1142/1 dhe 1142/7 të Zonës Kadastrale në Prizren, pasiqë kjo pjesë kadastrale nuk gjendet në zonën arkeologjike, në fakt Xhamia e Namazxhahut, vërtetë gjendet në afersi të këtij kompleksi banesor, por e njëjtë larg kompleksit banesor, dhe më e rëndësishmja është se kompleksin banesor me Xhaminë e Namazxhahut e ndan rruga kryesore dhe nuk është në vijë paralele me kompleksin banesor, në fakt Xhamia e Namazxhahut është më afér Ambulancës së qytetit.


Potencoja se kompleksi banesor është i ndërtuar me aktvendim të Drejtoretit për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, për shkaqe të pengesave objektive – një lokal që ka qenë afér nuk ka qenë e mundësuar që të ndërtohet aneksi banesor, i cili ka qenë i paraparë në plan rregullativ, për këtë posedojmë dokumentacionin e plotë, e me qenë se tani parcela në fjalë është liruar dhe mendojmë t'i fillojmë punimet e aneksit dhe se tani është paraqitur një pengesë rreth dhënieve së pëlqimit për ndërtimin e aneks ndërtesës së kompleksit banesor.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve, para se të merr këtë vendim është dashur që të dalë në vendngjarje, të vërtetojë gjendjen faktike ekzistuese, se ku gjendet i ndërtuar kompleksi banesor, ku gjendet Xhamia e Namazgjahut dhe të vërtetojë se me të vërtetë nuk ka asnjë pengesë rreth ndërtimit të aneksit të objektit banues i cili objekt është i ndërtuar me leje valide i lëshuar nga organi kompetent komunal në Prizren, për të cilën çështje prapë do t'i bashkangjesim vendimet për shikim, poashtu edhe pëlqimin nga Instituti për Mbrojtjen e Përmendoreve Kulturore të Komunës së Prizrenit, me numër 96/2 i datës 10.07.2008, i cili pëlqim dëshmon se ngastrat kadastrale ku është ndërtuar kompleksi banesor nuk gjenden në Zonën Arkeologjike dhe se nuk ka shtresa kulturore – arkeologjike.

Kërkojmë nga titulli i lartëpërmendur që të shqyrtojë në mënyrë urgjente kundërshtimin në vendimin me numër 08/2017 të datës 19.04.2017, pa udhëzim juridik, të del në vendshikim, të shqyrtojë dokumentacionin të cilin do të bashkangjesim në këtë kundërshtim, në mënyrë që të na ipet pëlqimi për ndërtimin e aneksit të kompleksit banesor, edhe pse të drejtat tona do t'i parashtrojmë në të gjitha organet kompetente deri në realizimin e kërkesës tonë.

Prizren, 27.04.2017

Paraqitësit e kundërshtimit,



The image shows three distinct handwritten signatures in black ink, each consisting of a stylized name followed by a surname, all written over three separate horizontal lines. The top signature is 'Rustem Shala', the middle is 'Mehmetaj', and the bottom is 'Dauti'.